

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Beqir Kalludra, me antarë të trupit Shadije Gërguri dhe Elife Uka, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Arianit Mahmutaj, në lëndën penale kundër të akuzuarve R.L dhe R.H për shkak të vepërs penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së dhe vepra penale nga neni 273 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP/Inr.533/2013 me dt.08.07.2014, pas përfundimit të seancës publike të shqyrtimit gjyqësorë, me dt.10.03.2016, në të cilat kanë prezentuar prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, të akuzuarit dhe mbrojtësi e tyre av.S.M dhe av.E.A, sipas autorizimit, me dt.10.03.2016 në të njëjtën ditë, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit :

R.L, i biri i Xh dhe F, e gjinisë K, i lindur më *data e lindjes*, në Gj, tani me vendbanim në P, lagjja B i D, bll..., nr..., student, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i republikës së Kosovës, dhe

R.H, me nofkën D, i biri i H dhe S, e gjinisë K, i lindur më *data e lindjes*, në fshatin S, komuna e S, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse

I akuzuari R.L me dt. *data e lindjes*, rreth orës 14:15 min në P në rrugën “...” paautorizim ka poseduar dhe shitur substanca narkotike të cilat janë shpallur e ligj si narkotik, ashtu që i pandehuri R.L ia ka shitur një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 2 gram të pandehurit R.H, ashtu që gjatë kontrollës nga ana e policisë të pandehurit R.L i është gjetur një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 4 gram dhe gjatë kontrollës në shtëpinë e tij janë gjetur një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 1.4 gram, një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë me peshë 5.1 gram dhe një qese me substancë narkotike të llojit hashish me peshë 0.7 gram si dhe disa qese të vogla najloni të zbrazta të cilat shërbejnë për paketimin e substancës narkotike, e të cilat janë konfiskuar nga ana e policisë,-

- me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së.

I akuzuari R.H me dt. 27.03.2013 rreth orës 14:15 minuta në P në rrugën “...” pa autorizim ka blerë substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 2 gram nga i pandehuri R.L siq është përshkruar në dispozitivin nr.1 të kësaj aktakuze, e që gjatë kontrollit nga ana e policisë të pandehurit R.H i është gjetur substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë të lartcekur prej 2

gram e cila është konfiskuar nga ana e policisë siç është përshkruar në dispozitivin nr.1 të kësaj aktakuze,-

- me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 275 par.2 të KPK-së

Prandaj kjo gjykatë në bazë të nenit 2, 4, 50, 51, 69, 273 par.2 , 275 par.2 të KPK-së, dhe nenit 359, 361, 365, 366, 450, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i:

GJYKON

Të akuzuarin R.L

Me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej 2 (dy), vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i njehti në periudhën kohore prej 2 (dy) vite, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, dhe

DËNIM ME GJOBË në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, Gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ua llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos i tejkalohet 6 muaj.

Të akuzuarin R.H

Me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njehti në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Konform nenit 69 të KPK-së konfiskohet sasia narkotike e sukuestruar dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e njëjta duhet të shkatërrohet.

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 100 (njëqind) Euro secili veç e veç, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/Inr.533/2013 me dt.08.07.2014, kundër të akuzuarit R.L për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së dhe kundër të akuzuarit R.H, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pas leximit të aktakuzës, të akuzuarit R.L dhe R.H, nuk e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe meqë të njëjtit nuk e kanë pranuar fajësinë, procedura ka vazhduar me procedimin e provave.

Pas përfundimit të procedurës së provave, prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, dhe i propozon gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të gjykojnë sipas ligjit, pasi që në këtë shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar se të njëjtit i kanë kryer veprat penale që iu vihen në barrë sipas kësaj aktakuze. Prokurori i shtetit vlerëson se gjendja e tillë faktike u vërtetua, nga raporti i ekspertizës, i dt.27.01.2014, nga i cili rezulton se substancat që janë sekuestruar të akuzuarit janë substanca narkotike të llojit marihuanë. Po ashtu edhe nga provat tjera materiale si : vërtetimi mbi marrjen e sendeve i dt.27.03.2013, raporti i bastisjes i dt.28.03.2013, si dhe nga fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, është vërtetuar fakti se tek të akuzuarit janë gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike. Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga dëgjimi i vetë të akuzuarve, të cilët duke u përpjekur t'i shmangen përgjegjësisë penale, kanë dhënë deklarata konfuzë dhe në kundërtënie të plotë me deklaratat e tyre të dhëna në fazat e mëhershme të kësaj procedure penale. Dhe, në fund dhe i propozon gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit, dhe me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal, ka kërkuar nga gjykata që t'i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për secilin të akuzuar veç e veç.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.L, av.S.M, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, prokuroria e shtetit nuk ka arritur ta vërtetojë faktin se i akuzuari R.L, ka shitur substancë narkotike dhe se me çfarë çmimi është shitur, qoftë të akuzuarit të dytë apo ndonjë personi tjetër, kur dihet se është fakt notor se çmimi i substancës narkotike për një cigare marihuanë nuk kushton as 10 euro, derisa një kese marihuanë shitet prej 5 euro. Andaj mbrojtja vlerëson se edhe sasia e cila i është gjetur të akuzuarit R.L prej 10-11 gramësh, ka qenë për përdorim personal dhe se nga kjo sasi, i akuzuari nuk ka shitur asnjë gram marihuanë. Dhe në fund i propozon trupit gjykues që ky i akuzuar në mungesë provave të lirohet nga akuza, ose gjykata të bëjë ricilësimin juridik të kësaj vepre penale.

I akuzuari R.L, e ka mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.H, av.A.E, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar më tej se i akuzuari edhe në fazat e mëhershme të zhvillimit të kësaj procedure penale, e ka pranuar se me rastin e kontrollimit nga policia, të njëjtit i është sekuestruar një sasi marihuanë prej 2 gram, dhe ka kërkuar nga gjykata që të bëjë ricilësimin e kësaj vepre penale, dhe atë nga neni 273 par.1, në nenin 275 par.2 të KPRK-së. Dhe në fund i ka propozuar gjykatës, që me rastin e shqyrtimit të matjes së dënimit, t'i vlerësojë rrethanat lehtësuese se i mbrojturi i tij asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, është i moshës së re, i njëjti i ka pranuar veprimet inkriminuese, si dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëritë këtë vepër penale.

I akuzuari R.H, e ka mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Pas procedimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 8 par. 2 dhe 361 par.2 të KPPRK-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje të tillë të fakteve, Gjykata e ka vërtetuar nga të gjitha dëshmitë dhe provat materiale që janë proceduar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, dhe atë nga procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave, të datës 27.03.2013, nga raporti i bastisjes i dt.28.03.2013, nga raporti i

ekspertizës i përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë - Njësia e shkencave ligjore - analiza kimike në Prishtinë, të dt.27.01.2014, lidhur me llojin e substancës narkotike, nga vërtetimi mbi marrjen e gjëseneve të dt.27.03.2013, fotoalbumi i dt.27.03.2013, si dhe fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës.

Nga procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave, të datës 27.03.2013, vërtetohet fakti se në vendbanimin e prindit të të akuzuarit Xh.L në P, në të cilën banesë banon edhe i akuzuari R.L, janë gjetur dhe sekuestruar tri qese najloni, me substancë të dyshuar narkotike, si dhe disa qese të vogla najloni.

Nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve të dt.27.03.2013, vërtetohet fakti se në vendbanimin e prindit të të akuzuarit R.L, me rastin e bastisjes janë konfiskuar përkohësisht tri qese me bari të gjelbër narkotikë të dyshuar si mariuhanë, me peshë prej 10.50 gram, një qese me substance të ngurtë, e llojit hashash me peshë 0.7 gram dhe 55 euro monedha të letrës, derisa të akuzuarit R.H i janë gjetur dhe sekuestruar një qese me bari me ngjyrë të gjelbër, e cila është vërtetuar se është substancë narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 2 gram.

Po ashtu kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga fotodokumentacioni në shkresat e lëndës ku nga këto foto vërtetohet se substancat narkotike të sekuestruara kanë peshuar 5.1071.4 gram.

Nga raporti i ekspertizës i përgaditur nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, i datës 27.01.2014, pas ekzaminimit të substancës të sekuestruar në vendbanimin e të akuzuarit, vërtetohet fakti se në këto materie është prezent substanca narkotike e llojit Kanabis - Marihuanë, me përmbajtje Tetrahidrokanabinol (THC).

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit R.L të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku i njëjti e ka mohuar në tërësi faktin se ka shitur substancë narkotike, duke shtuar se asnjëherë nuk ka shitur substancë narkotike, se të akuzuarit R.H atë sasi të vogël të kësaj substance, ia ka dhënë pa pranuar kundërshpërbllim për faktin se me të njëjtin janë shokë që moti, se me të njëjtin, ka raporte shumë të mira edhe familjare, se sasinë e narkotikëve e cila i është gjetur me rastin e bastisjes, e ka përdorë vetëm për nevoja personale, për faktin se i njëjti ka qenë konsumues i kësaj substance, dhe tani më ka pushuar së konsumuari. Ndërkaq i akuzuari është ballafaquar me deklaratat e dhëna në fazat e mëhershme të kësaj procedure penale nga kryetari i trupit gjykues, pasi që këto deklaratat ishin në kundërthënie me deklarinimin e tij para trupit gjykues, dhe në ballafaqimin me deklaratën dhenë në polici me dt.27.03.2013, ku ka deklaruar se R e njoh qe një vit, tani deklaron se këtë deklaratë e ka dhënë nën presion të policisë, sepse R e ka njohur qe 5 vite, kjo ka qenë në kohën kur është marrë në intervistë, dhe se tani janë 8-9 vite nga ajo kohë. Po ashtu, në ballafaqimin me deklarinimin e tij në seancë të shqyrtimit gjyqësor, se atë sasi narkotike të sekuestruar e ka siguruar përmes një personi nga Kukësi, Republika e Shqipërisë, derisa në polici kishte deklaruar se këtë substancë-marihuanë ia ka dhënë një person i quajtur K, tani i njëjti deklaron se "nashta osht ai shqiptari në Kukës që e kam marrë, rastësisht jam takuar dhe mo nuk e kam takuar fare", tani i njëjti deklaron se ndoshta ka gabuar prokurori, se nuk ka deklaruar kështu.

Andaj, Gjykata, bazuar në këto deklarime kundërthënëse, jo të sinqerta, jo bindëse dhe jo të bazuara në prova konkrete mbështetëse të të akuzuarit R.L, dhe krahasuar me provat e dëshmitë e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, vlerëson se pretendimet mbrojtëse të të akuzuarit R.L, janë përpjekje të drejtuara vetëm e vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, e me këtë edhe vendimit mbi dënim, dhe se gjykata ia falë besimin deklaratës dhënë në Polici e Prokurori,

e cila deklaratë është dhënë menjëherë pas kryerjes së veprës penale, dhe se i akuzuari ka qenë i singertë dhe e ka treguar të vërtetën, dhe nuk ka ditur ta shtrembëroj atë.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit R.H, i cili ka deklaruar se një kohë të shkurtër e ka konsumuar substancën narkotike, dhe atë zakonisht për festa apo edhe për shkak të ngarkesës me punë fizike, mirëpo ka deklaruar se atë sasi të marihuanës, nuk e ka blerë nga tani i akuzuari R1, por vetëm e ka huazuar për shkak të miqësisë mes tyre, duke i mohuar në tërësi deklaratën e tij të dhënë në Prokurori, ku i njëjti ka deklaruar se ka pas kontakt me një vajzë me emrin M.K, të cilën ditën kritike diku rreth orës 15:30 min., e ka thirrë në telefon për me marrë një numër të telefonit kontaktues të një personi i cili shet substancë narkotike të llojit marihuanë, dhe pas ballafaqimit me këtë deklaratë, i akuzuari R.H deklaroi se "e vërteta është se nuk kam blerë drogë por e kam marrë në formë jaranie". Dhe pas vazhdimit të ballafaqimit me deklaratën e dhënë në Prokurori ku i njëjti ka deklaruar se substancën narkotike të llojit marihuanë me peshë 10 gram, e ka blerë me çmimin prej 10 euro, dhe se në pyetjen se pse keni deklaruar kështu, i njëjti përgjigjet për shkak të presionit që ka pas në polici, duke mos e arsyetuar me asnjë provë këtë presion. Po ashtu edhe lidhur me njohjen e të akuzuarve me njëri-tjetrin është bërë ballafaqimi i deklaratës së të njëjtit, dhe derisa në prokurori ka deklaruar se personin prej të cilit e ka blerë substancën narkotike, e ka parë për herë të parë me dt.27.03.2013. dhe këtë person nuk e ka njohur më parë, i akuzuari deklaroi se kështu ka deklaruar për shkak se ka pasur frikë në prokurori. Dhe më tutje pas vazhdimit të ballafaqimit në deklaratën dhënë në polici, ku ka deklaruar se qëllimi i kontaktimit me këtë person ka qenë vetëm me blerë marihuanë nga ai, po ashtu e mohon këtë deklaratë duke shtuar se këtë e ka bërë nga presioni që ka pasur nga policia. Po ashtu edhe njohja me njëri tjetrin nuk është përputhur me deklaratat e dhëna në fazat e mëhershme të kësaj procedure penale, derisa në seancë të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me të akuzuarin R1 është njohur në fakultet, në polici ka deklaruar se "veç i kam treguar që jam një shok i M dhe që e kemi lanë mu takuar pranë kafiterisë ..". Edhe me rastin e ballafaqimit me faktin se i njëjti nuk e ka njohur të akuzuarin më parë, ku në polici ka deklaruar se personi që ka kontaktuar me nr.tel.../...-... (të cilin e ka shfrytëzuar i akuzuari R.L), i akuzuari R ka deklaruar se 'nuk e di qysh quhet, është hera e parë që sot e kam takuar dhe me te jam takuar një minutë më herët para se të na ndalë policia', po ashtu tani përgjigjet se këtë deklaratë e ka dhënë nga presioni, duke mos dhënë asnjë provë se dëshminë e ka dhënë nën presion qoftë të Policisë a Prokurorisë. Andaj, Gjukata, këto deklarime kundërtënjësore i ka vlerësuar si jo të sinqerta dhe jo reale dhe të bazuara në prova konkrete, dhe vetëm si pretendime mbrojtëse të të akuzuarit R.H, vetëm e vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale dhe të mos e ngarkoj të akuzuarin R.L me veprimet e tij inkriminuese, andaj, edhe për këto fakte, gjykata ia falë besimin deklaratave të dhëna në Polici e Prokurori, ku i akuzuari ka qenë i singertë dhe e ka treguar të vërtetën, dhe se këto deklarata janë në përputhshmëri dhe harmoni me të gjitha provat tjera materiale, dhe me rrjedhën logjike të kësaj ngjarje penale.

Andaj, nisur nga këto rrethana të vërtetuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit R.L, manifestohen të gjitha elementet qenësore dhe tiparet e figurës së veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së, derisa për të akuzuarin R.H, gjykata duke pas për bazë faktin se për këtë të akuzuar është vërtetuar në mënyrë të padyshimtë fakti se ka poseduar vetëm 2 gram të substancave narkotike, gjykata ka bërë ricilësimin e kësaj vepre penale, dhe të akuzuarin R.H e ka shpallur fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së.

Dhe, meqenëse gjykata nuk gjeti rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarve, e duke qenë të gjithë të akuzuarit penalisht përgjegjës, të njëjtit edhe i shpalli fajtor dhe ua shqiptoj sanksionet penale përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarit R.L dhe R.H, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese vlerësoi sjelljet korrekte të të njëjtëve pas kryerjes së kësaj vepre penale dhe gjatë tërë procedurës penale, faktin se kjo Gjykatë nuk ka të dhëna së të njëjtit kanë qenë të gjykuar a dënuar më parë, pendimin e thellë të të njëjtëve për këtë vepër penale, dhe premtimin se në të ardhmen nuk do i përsëritin asnjëherë këto veprime, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale, derisa për të akuzuarin R.L, si rrethanë veçanërisht lehtësuese vlerësoi faktin se i njëjti është në përfundim të ndërtimit të tij profesional dhe ardhmërisë së tij, dhe gjykata vlerësoi se të njëjtit duhet dhënë një rast për rehabilitim dhe resocializim pa kufizim të lirisë, duke pas për bazë edhe faktin se të njëjtit i është gjetur dhe konfiskuar sasi e vogël substancash narkotike dhe llojin e substancës narkotike, prej 11.20 gram, dhe në mungesë të rrethanave rënduese për të dy të akuzuarit, gjykata të njëjtëve ua shqiptojë sanksionet penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimet e shqiptuara, janë në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarve, dhe se do të ndikoj në riedukimin dhe risocializimin e të akuzuarve, si dhe këto dënime do të ndikojnë edhe te të tjerët që të mos kryejnë vepra të tilla apo të ngjajshme penale, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e substancës narkotike, është marrë konform nenit 69 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarve, konform nenit 450 par. 3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.382/14, dt.10.03.2016

Procesmbajtësi
Arianit Mahmutaj

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.